



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Projektvendim

“Për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe””

Në mbështetje të neneve 78, pika 1, dhe 83, pika 2, të Kushtetutës, si dhe të neneve 28 dhe 55, pika 1, 2, 3 dhe 4 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

- I. Të shqyrtojë me procedurë të përshpejtuar projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe””
- II. Shqyrtimi në komisionin përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin të bëhet në datat 11-12 tetor 2019.
- III. Komisione për dhënie mendimi caktohen komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe komisioni për Politikën e Jashtme.
- IV. Shqyrtimi në seancë plenare të bëhet në datën 14 nëntor 2019.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 04.11.2019